



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0537

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj - Mexhuani Kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE “AS Tech” SH.P.K.- Prishtinë, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve” me numër të prokurimit 632-23-5490-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KK Gjakovë”, më 21.11.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “AS Tech” SH.P.K.- Prishtinë të datës 01.08.2023, me numër të protokollit 2023/0537, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve” me numër të prokurimit 632-23-5490-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KK Gjakovë” ndërsa aktivitetit të prokurimit kthehet në Rivlerësim
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.
3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.05.2023, “KK Gjakovë”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve” me numër të prokurimit 632-23-5490-1-2-1. Ndërsa me datën 05.07.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë GOE “KIGA SH.P.K”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 49,982.20 €.

Me 19.07.2023, OE “AS Tech” SH.P.K.- Prishtinë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 24.07.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 01.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “AS Tech” SH.P.K.- Prishtinë me nr. 537/23 lidhur me aktivitetin “Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve” me numër të prokurimit 632-23-5490-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AS Tech" SH.P.K.- Prishtinë janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi

Pretendimi i -II- ankuesi pretendon se "OE Uraniku përveç që nuk e ka sjell certifikatën për një serviser, stafin për të cilët ka sjell certifikatë të servisimit nuk janë pjesë e listës së stafit. Kërkesë e AK-se ka qene: Lista e punëtorëve, CV-a, certifikatat profesionale, kontrata e punës valide me ofertuesin, në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë. OE Uraniku ka sjell vetëm disa certifikata por ata janë të personave që nuk janë pjesë e listës, përderisa janë dokumente të personave jashtë listës nuk duhet të merren në vlerësim aspak, sepse AK vete ka kërkuar të dorëzohet lista e punëtorëve. OE është dashur të dorëzoj Listën e tere stafit të angazhuar për këtë projekt të cilët kane mund te jene të rregullt apo të angazhuar me para kontratë, por qe duhet me çdo kusht të jene të listuar si staf, e pastaj nga lista e prezantuar AK ka mundur te kërkojë sqarime tjera, ndërsa kur punëtorët nuk janë të shkruar në listë nuk mund të kërkojen sqarime për ta (në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim nuk është shqyrtuar ky pretendim)."

Pretendimi i -III- ankuesi pretendon se "OE "Infinit" nuk ka dorëzuar dëshmi për certifikata të stafit të kërkuar (në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim nuk është shqyrtuar ky pretendim)".

Pretendimi i -IV- ankuesi pretendon se "AK e ka eliminuar ofertën tone me arsyetimin se nuk kemi sjell dëshmi të stafit, edhe pse ne oferte kemi dorëzuar Listën e stafit, por për shkak të vëllimit të madhe dhe kohës së shkurtër i kemi ngarkuar vetëm dokumentet tjera, me mendimin se AK duhet te kërkojë sqarime pastaj. AK gjate procesit te vlerësimit te tenderëve ka mundur te kërkojë sqarime shtese sepse ato dokumente i kemi, janë dokumente ekzistenca e te cilave dihet para hapjes, por AK nuk ka kërkuar aspak sqarime vetëm e ka eliminuar ofertën tone. Ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim AK nuk e shtjelloj me shume këtë pretendim vetem e vlerëson te pabazuar, ndërsa edhe oferta e konzorciumit te shpërblyer nuk i ka pasur dëshmitë e stafit nga qasja qe e kemi pasur, ndërsa pastaj në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim janë bashkangjitur disa dëshmi të certifikatave. Dmth AK kompaninë tone As tech SHPK e eliminon se nuk i ka dorëzuar dëshmitë bashkë me ofertë ndërsa konzorciumin e rekomanduar e shpërblejnë dhe me gjase i ka kërkuar sqarime, këtu AK ka bere shkelje të nenit 7 dhe 59 sepse nuk i ka trajtuar OE njësoj dhe nuk e ka bere siç duhet vlerësimin e tenderit. Kërkojmë kthim te lendes ne rivlerësim dhe shpërblim te ofertës tonë me kontratë."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "AS Tech" SH.P.K.- Prishtinë konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60, të LPP , duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 02/08/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 537/23, ndërsa me datë 09/08/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0537 me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “ AS TECH ” SH.P.K të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në mungesë të ofertave të përgjegjshme. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, AK nuk pajtohet me ekspertizën me nr2023/0537 për arsye si në vijim: OE i rekomanduar siç e ka cekur edhe eksperti ka ofruar kontratë dhe referencë siç është kërkuar në FDT. Kërkesa e FDT ishte që OE të ofroj së paku një kontratë ose një referencë. OE i rekomanduar e ka plotësuar këtë kërkesë dhe për ne është i përgjegjshëm si dhe ka çmimin më të lirë.”* Ndërsa OE me raportin e ekspertit shqyrtues deklarojë se OE As Tech nuk pajtohet që aktiviteti i prokurimit të anulohet sepse konsiderojmë se oferta jone nuk është vlerësuar si duhet. Eksperti ofertën tone e vlerëson si me të shtrenjte dhe që ne kemi dorëzuar vetëm listën e punëtorëve por jo edhe dëshmitë përcjellëse. Ndërsa nuk e përmend faktin që AK te proces te vlerësimit ka mundur të kërkojë sqarime rreth dëshmimeve nga lista siç e thotë edhe ligji që ne rast se dorëzohet lista mund të kërkojnë sqarime për dëshmitë e saj. Ne ju garantojmë se i kemi ne dispozicion dëshmitë sipas kërkesës se AK-se te datuara para hapjes se ofertave, por AK nuk ka qene e interesuar te shpërblej ofertën tone madje meqenëse kemi qene oferta me e shtrenjtë nuk ka kërkuar as sqarime, por tani meqenëse ofertat tjera janë vlerësuar te papërgjegjshme për arsye te ndryshme kërkojmë kthimin e lendes ne rivlerësim, shfrytëzimin e legjislacionit primar dhe sekondar të LPP-se për informacione shtese dhe rrjedhimisht shpërblimin e ofertës tonë me kontrata. Lidhur me pretendimet e OE “AS Tech” SH.P.K.- Prishtinë eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0537 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) është i bazuar “ Përgjigjet ne Pikat e ankesës ndaj Grupit te OE «KIGA SE.P.K.;, LEMKOS SH.P.K.”- Fushe Kosovë të rekomanduar për kontrate. Pretendimi ankimor i O ankues Është se Grupi i Operatoreve Ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk kanë plotësuar kërkesat mbi mundësit/teknike dhe/ose profesionale ne dosjes se tenderit dhe njoftimin për kontrate. Kërkesa: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se ngjashme ne 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontrate Dëshmia: Lista e kontratave në të cilën specifikohen te gjitha furnizimet e realizuara ne 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar furnizimet e kryera shumën e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit te mire te furnizimeve - (se paku ne reference ose raport të pranimit të furnizimeve e cila përputhet me listën e dorëzuar). Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ne bazë te dokumenteve të dorëzuara në ofertën e tyre ky Grup i OE kane dorëzuar listën e kontratave duke ju bashkangjitur referencat për furnizimet që i ka realizuar. Ne bazë të referencave të dorëzuara nga Grupi i OE i rekomanduar për kontrate si dhe listës se kontratave referencat nuk janë të natyrës se ngjashme ashtu siç është kërkesa ne dosjen e tenderit. Vetëm anëtar i grupit “ KIGA” ka dorëzuar listën e kontratave si dhe referencat. Referenca e lëshuar nga Komuna e Podujevës për kontratën "Furnizim me pajisje mjekësore për nevoja te QKMF-se Llot -IV " është kontrate e natyrës se ngjashme mirëpo nuk është ne listën e kontratave ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit. Ndërsa referencat tjera kane te bëjnë me furnizim me material higjenik, furnizim me pelet që nuk janë referenca te ngjashme ashtu siç është kërkesa ne dosjen e tenderit. Duke ju referuar kriterit te sipër përmendura me larte dhe dëshmime të dorëzuara, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i bazuar.

Pretendimi i dytë (II) është pjesërisht i bazuar “Pretendimi ankimor i OE ankues se është Grupi i Operatoreve Ekonomik te rekomanduar për kontrate nuk- kane plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosjes se tenderit dhe njoftimin për kontrate Kërkesa: Operatori Ekonomik: duhet të ofroje dëshmi se ka së paku 4 (katër) servisera te mjaftueshëm si dhe të këtë staf profesional për kryerjen e furnizimit. Dëshmia: Lista e punëtorëve, CV-a, certifikatat profesionale, kontrata e punës valide me ofertuesin, në rast ta lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për te cilin ka lidh kontratë. Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE te rekomanduar për kontrate ne bazë të dokumenteve te dorëzuara. Në ofertën e tyre ky Grup i OE kane dorëzuar si dëshmi vetëm kontratat për 4 (katër) servisera. Autoriteti Kontraktues përmes letrës standarde e Kërkesës për sqarimin e tenderit ka kërkuar sqarime shtese . Edhe pse ka kërkuar sqarime shtese Grupi i OE nuk ka arrit të dëshmoj Listën e punëtorëve por vetëm ka dëshmuar CV dhe certifikatat profesionale për 4 servisera. Duka ju referuar kriterit te sipër përmendure me larte, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është pjesërisht i bazuar pasi që mungon lista e punëtorëve.

Pretendimi i tretë (III) është i bazuar “Përgjigjet ne pikat e ankesës se ndaj Operatorit Ekonomik “URANIKU-SG SH.P.K, pretendimi ankimor i OE ankues se Operatorit Ekonomik URANIKU-SG SH.P.K nuk e ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontrate. Kërkesa: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka se paku 4(katër) servisera të mjaftueshëm si dhe te këtë staf profesional për kryerjen e furnizimit. Dëshmia Lista e punëtorëve, CV-a, certifikatat profesionale., kontrata e punës valide me ofertuesin, ne rast te Lidhjes se kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për te cilin ka lidhë kontratë. Eksperti shqyrtues sqaron se Operatori Ekonomik: " Uranik-SG" ne bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertën e tij, ky Operator Ekonomik ka dorëzuar listën e punëtorëve, ku janë kërkuar 4 servisera Ky Operator Ekonomik: ka prezantuar dy servisera me para kontratë të cilët nuk janë ne listën e punëtorëve të dorëzuar ne oferte si dhe mungon në certifikata e serviserit, CV. Duke ju referuar pretendimit ankimor të sipër përmendura me larta, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimorë i Ankuesit është i bazuar.”

Pretendimi i katërt (IV) është i bazuar “Përgjigje në Pretendimi ankimor i OE ankues se Operatori Ekonomik INFINITT " nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknikë dhe/ose profesionale ne dosjes se tenderit dhe njoftimin për kontratë Kërkesa: Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se la se paku 4 (katër) servisera të mjaftueshëm si dhe te këtë staf profesional për kryerjen e furnizimit.Dëshmia: Lista e punëtorëve, CV-a, certifikatat profesionale, kontrata e punës valide me ofertuesin, ne rast te lidhjes se kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për te cilin ka lidhe kontrate. Eksperti shqyrtues sqaron se Operatori Ekonomik: " Infinitt" ne baze ta dokumenteve të dorëzuara ne ofertën e tij. ky Operator Ekonomik nuk ka dorëzuar listën e punëtorëve mirëpo ka dorëzuar letër (4) para kontrata për katër (4) servisera ku ju mungojnë CV, certifikatat profesionale. Ky Operator Ekonomik: ka prezantuar katër (4) servisera me para kontratë për të cilët nuk la dorëzuar listën e punëtorëve ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit. Duke ju referuar pretendimit ankimor te sipër përmendurë me larta, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit është i bazuar.

Pretendimi i katërt (V) është i pa bazuar “ Pretendimi ankimor i OE ankues "AS TECH" SH.P.Kse është eliminuar pasi që nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate. Kërkesa: Operatori Ekonomik: duhet të ofroje dëshmi se ka se paku 4 (kater) servisera te mjaftueshëm si dhe të këtë staf profesional për kryerjen e furnizimit. Dëshmia: Lista e punëtorëve, CV-a, certifikatat profesionale, kontrata e pumës valide me ofertuesin, ne rast te lidhjes se kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për te cilin ka lidhe kontrate. Eksperti shqyrtues sqaron se Operatori Ekonomik: “AS tech” ne baza te dokumenteve të dorëzuara ne ofertën e tij, ky Operator Ekonomik: ka dorëzuar listën e punëtorëve mirëpo nuk ka dorëzuar Kontrata apo para kontrata për katër (4) servisera, nuk ka dorëzuar asnjë CV për servisera si dhe nuk: la dorëzuar asnjë certifikata profesionale për sarvisera. Duke ju referuar pretendimit ankimor të sipër përmendure me lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimore i Ankuesit Është i pa bazuar. OE ankues është ofertë me çmimi me te larte se të gjithë operatoret tjerë pjesëmarrës për këtë Aktivitet te prokurimit. Te gjithë ofertuesit pjesëmarrës ne këtë aktivitet janë të pa përgjegjshëm qe nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara ne dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrata.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdes profesional i ka administruar dhe vlerësuar të gjitha provat në shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 59 të LPP, përderisa nuk i ka përdorur apo zbatuar me kohë dhe gjatë rrjedhës së aktivitetit kompetencat e tij në vështrim të paragrafit 2, të dispozitës së cituar sipas së cilës Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve, meqenëse ankuesi në rastin konkret e kishte ofruar listën e punëtorëve, andaj duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës sipas gjykimit të pavarur të panelit duke u bazuar edhe në LPP dhe RRPP, UPP ky aktivitet duhet të kthehet në rivlerësim dhe duhet obliguar AK që të kërkojë sqarime shtesë nga Operatorët Ekonomik të tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet në zbatim të nenit 1,6,7 të LPP-së. Përmes nenit 1 të LPP përcaktohet se “*Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese...*”. Përmes nenit 6 të LPP përcaktohet se “*Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit*”. Paneli Shqyrtues bazuar në të lartcekurat thekson që Autoriteti Kontraktues me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të drejtë të ofertave duhet të kërkojë edhe sqarime shtesë nga ofertuesit në kuptim të nenit 72 të LPP dhe lidhur me nenin 38 paragrafin 38.1 të RRPP. Përmes nenit 72 të LPP përcaktohet se “*Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji*” kurse parg 3 përcaktohet “*Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive*”. Ndërsa përmes nenit 38 paragrafit 38.1 të RRPP përcaktohet

se “Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja bëhen përmes platformës elektronike”.

Kurse sa i përket të rekomanduarit Paneli mbështet raportin e ekspertit shqyrtues i cili ka konstatuar se i njëjtui është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në rivlerësim në zbatim të nenit 1, 6 dhe 7 të LPP..

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - " AS Tech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: